



PROPOZIM

Në bazë të nenit 48, paragrafit (1), pikës 3) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 110/21) dhe pikës 9) të Vendimit për llojin e raporteve për funksionimin e sistemeve pagesore dhe mënyrës dhe afateve për dorëzimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 271/22), guvernatorja e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

UDHËZIM

për përmbajtjen dhe formën e raporteve të funksionimit të sistemeve pagesore

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim definohet përmbajtja dhe forma e raporteve për funksionimin e sistemeve pagesore, të cilët operatorët e sistemeve pagesore janë të obliguar t'i dorëzojnë te Banka Popullore në pajtim me Vendimin për llojin e raporteve për funksionimin e sistemeve pagesore dhe mënyrën dhe afateve për dorëzimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 271/22) (në tekstin e mëposhtëm: Vendimi).

II. PËRMBAJTJA DHE FORMA E RAPORTEVE TË RREGULLTA

2. Operatori i sistemit pagesor i dorëzon raportet për funksionimin e sistemit pagesor nga pika 2) të këtij vendimi, përmbajtja e së cilit është përshkruar në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.

3. Operatori i sistemit pagesor dorëzon raport për funksionimin e operatorit të sistemit pagesor nga pika 3), paragrafi (1), nënparagrafi (1) të këtij vendimi, për aktivitetet e revizioneve të cilat janë kryer vitin e kaluar, e cila veçanarisht përmban:

- përshkrim të brendshëm të kryer, të jashtëm dhe revizion tjetër të lidhur me funksionimin e operatorit të sistemit pagesor;
- gjetjet e funksionimit të operatorit të sistemit pagesor, dhe
- emri, mbiemri, telefoni, adresa elektronike dhe nënshkrimi i personit përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e raportit.

4. Operatori i sistemit pagesor dorëzon raport për punën e operatorit të sistemit pagesor nga pika 3), paragrafi (1), dhe nënparagrafi (2) të vendimit, për planin vjetor të aktiviteteve të revizioneve të vitit aktual i cili përmban përshkrim të planifikuara të revizioneve të brendshme, të jashtme dhe të tjera të lidhura me funksionimin e operatorit të sistemit pagesor.

5. Operatori i sistemit pagesor dorëzon raport për menaxhim me rreziqet nga pika 4), paragrafi (1), nënparagrafi (1) të vendimit për çdo testim të kryer të zgjidhjeve dhe procedurave të rregullta dhe rezerve për vitin e kaluar, e cila përmban informacionet e mëposhtme:



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- lënda dhe fushëveprimi i testimit;
- qëllimet e testimit;
- periudha që përfshihet me testimin;
- person përgjegjës dhe pjesëmarrës në testim;
- skenar për testimin;
- rezultatet nga testimi;
- masat korigjuese të cilat janë miratuar në pajtim me rezultatet e testimit me një afat kohor për zbatimin e tyre, dhe
- zbatimi i masave të definuara në raportimet e kaluara për menaxhim me rreziqet.

6. Operatori i sistemit pagesor dorëzon raport për menaxhim me rreziqet nga pika 4), paragrafi (1), nënparagrafi (2) të vendimit për çdo vlerësim të kryer për rreziqet në sistemin pagesor për vitin e kaluar, e cila përmban:

- lëndën dhe fushëveprimin e vlerësimit të rreziqeve;
- qëllimet e vlerësimit të rreziqeve;
- metodologjia e cila zbatohet gjatë vlerësimit të rreziqeve;
- rezultatet e vlerësimit të rreziqeve;
- masat për menaxhimin me rreziqet të miratuara në bazë të vlerësimit të rreziqeve, me kufizim kohor për zbatimin e tyre, dhe
- zbatimi i masave të definuara në raportimet e kaluara për menaxhim me rreziqet.

7. Operatori i sistemit pagesor dorëzon raport për menaxhim me rreziqet nga pika 4), paragrafi (1), nënparagrafi (3) të vendimit, për planin vjetor të aktiviteteve për testimin e zgjidhjeve dhe procedurave të rregullta dhe rezerve të rreziqeve në sistemin pagesor në vitin e aktual, e cila përmban:

- plan për testim të zgjedhjeve dhe procedurave të rregullta dhe rezervë (lënda dhe fushëveprimi i testimit, qëllimet e testimit, periudha e planifikuar për testim dhe person përgjegjës dhe pjesëmarrës në testim) dhe
- plan për zbatim të vlerësimit të rreziqeve (lënda dhe fushëveprimi i vlerësimit të rreziqeve, qëllimet e vlerësimit të rreziqeve, periudha e vlerësimit të rreziqeve dhe metodologjia e parashikuar e cila do të përdoret për vlerësimin e rreziqeve).

III. PËRMBAJTJA DHE FORMA E RAPORTEVE TË JASHTËZAKONSHME PËR NDRYSHIMET DHE INCIDENTET E PLANIFIKUARA DHE/OSE TË KRYERA

8. Operatori i sistemit pagesor sjell raport për ndryshime të statusit dhe të tjera që janë të lidhura me pjesëmarrësit në sistemin pagesor nga pika 5), paragrafi (1) të vendimit, i cili përmban:

- emrin e pjesëmarrësit në sistemin pagesor për të cilin është raportimi;
- përshkrim të ndryshimit të statusit ose ndryshimin e lidhur me pjesëmarrjen e pjesëmarrësit (përfshirje, tërheqje, përjashtim, ndryshim nga pjesëmarrës indirekt në pjesëmarrës të drejtëpërdrejtë dhe anasjelltas);
- data e ndryshimit të statusit ose ndryshimi i lidhur me pjesëmarrjen e pjesëmarrësit dhe



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- vlerësimi i ndikimeve të mundshme të ndryshimit të statusit ose ndryshimit të lidhur me pjesëmarrjen e këtij pjesëmarrësi, të përcaktuara në nënparagrafin (2) të kësaj pike, mbi funksionimin e sistemit pagesor ose rreziqet e tij.

9. Operatori i sistemit pagesor dorëzon raport për rënie dhe çrregullime në funksionimin e sistemit pagesor; sistemin pagesor nga pika 6), paragrafi (1) të Vendimit, i cili përmban:

- përshkrimi i incidentit (lloji i incidentit ose ngjarje tjetër, arsyeja dhe indikacionet në cilën pjesë të procesit ka ndodhur gabimi);
- data dhe koha e incidentit;
- përshkrimi i pasojave të incidentit dhe ndikimi i tyre për secilin pjesëmarrës veçmas (sipas emrin të pjesëmarrësit) ose të sistemit pagesor në tërësi;
- përshkrimi i tranzicionit të zbatuar ose të planifikuar drejt funksionimit normal;
- përshkrimi i raportimeve (pranues të raportimeve dhe mënyrës që përdoret për raportim të pjesëmarrësit në sistemin pagesor);
- lista e masave për parandalimin e paraqitjes së llojeve të tilla të incidenteve ose gabimeve në të ardhmën dhe
- periudha kohore për zbatimin e masave nga nënparagrafi (6) i kësaj pike.

10. Përkrah raportit nga pika 9) të këtij udhëzimi, operatori dorëzon së pari raport për rënie dhe çrregullime në funksionimin e sistemit pagesor, në pajtim me pikën 6), paragrafin (2) të vendimit, nëpërmjet postës elektronike në adresën elektronike nadzor_ps@nbrm.mk, e cila përmban:

- përshkrim të incidentit (lloji i incidentit ose ndonjë ngjarje tjetër, arsyeja dhe indikacionet në cilën pjesë të procesit ka ndodhur gabimi) dhe
- data dhe koha e incidentit.

11. Operatori i sistemit pagesor dorëzon raport për ndryshimet e planifikuara në funksionimin e sistemit pagesor nga pika 7) të vendimit, i cili përmban:

- Përshkrim të detajuar thelbësor të ndryshimeve të planifikuara në funksionimin e sistemit pagesor;
- orar kohor të zbatimit të ndryshimeve dhe personave përgjegjës për çdo aktivitet veçanarisht dhe
- vlerësim të ndikimit mbi udhëheqjen me rreziqet në sistemin pagesor.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

12. Në ditën e zbatimit të këtij vendimi ndalon se vlejti Udhëzimi për Raportim nga Operatorët e Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.13/17 dhe 133/17).

13. Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

**U. nr. 02-1711/1
18.01.2023
Shkup**

**Guvernatorja
e Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së
Veriut**

д-р Анита Ангеловска-Бежоска



Shtojca 1. Raportet për funksionimin e sistemit pagesor

Tabela 1: Numri dhe vlera bruto e transfertave kreditore të kryera në sisteme për pagesa të mëdha sipas pragut të vlerës në denarë

Kategoritë në denarë	Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
Deri 500						
Më shumë se 500 deri në 1000						
Më shumë se 1.000 deri në 5.000						
Më shumë se 5.000 deri në 10.000						
Më shumë se 10.000 deri në 50.000						
Më shumë se 50.000 deri në 100.000						
Më shumë se 100.000 deri në 250.000						
Më shumë se 250.000 deri në 500.000						
Më shumë se 500.000 deri në 1.000.000						
Më shumë se 1.000.000 deri në 10.000.000						
Më shumë se 10.000.000 deri në						
Më shumë se 100.000.000 deri në						
Më shumë se nga 1.000.000.000						

Tabela 1.1: Numri dhe vlera bruto e transfertave kreditore të kryera në sisteme për pagesa të mëdha sipas pragut të vlerës në Euro

Kategoritë në Euro	Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
Deri 20						
Më shumë se 20 deri në						
Më shumë se 100 deri në						
Më shumë se 500 deri në 1.000						



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Më shumë se 1.000 deri në 5.000						
Më shumë se 5.000 deri në 10.000						
Më shumë se 10.000 deri në 50.000						



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Më shumë se 50.000 deri në 100.000						
Më shumë se 100.000 deri në 500.000						
Më shumë se 500.000 deri në 1.000.000						
Më shumë se 1.000.000						

Tabela 1.2: Numri dhe vlera bruto e transfertave kreditore të kryera në sisteme për pagesa të vogla sipas pragut të vlerës në denarë

Kategoritë në denarë	Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
Deri 500						
Më shumë se 500 deri në						
Më shumë se 1.000 deri në 5.000						
Më shumë se 5.000 deri në 10.000						
Më shumë se 10.000 deri në 50.000						
Më shumë se 50.000 deri në 100.000						
Më shumë se 100.000 deri në 250.000						
Më shumë se 250.000 deri në 500.000						
Më shumë se 500.000						

Tabela 2: Numri dhe vlera bruto e transaksioneve me kartela pagesore sipas pragut të vlerës

Kategoritë në denarë	Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
Deri 250						
Më shumë se 250 deri në						
Më shumë se 500 deri në 1.000						
Më shumë se 1.000 deri në 5.000						
Më shumë se 5.000 deri në 10.000						
Më shumë se 10.000 deri në 20.000						
Më shumë se 20.000 deri në 30.000						
Më shumë se 30.000						



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Operatori i Sistemit pagesor dorëzon të dhëna në katër tabelat me të cilat raportohet individualisht për transaksionet e kryera pagesore.

- në vendet fizike të shitjes



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- në vendet virtuale të shitjes
- për arsye të tërheqjes së parave të gatshme; dhe
- për arsye të deponimit të parave të gatshme.

Tabela 3: Numri dhe vlera bruto e transaksioneve sipas orëve

Prej - deri (në interval prej 1 ore)	Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)		Muaj (MM.VVVV)	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
00:01-01:00						
01:01-02:00						
02:01-03:00						
03:01-04:00						
04:01-05:00						
05:01-06:00						
06:01-07:00						
07:01-08:00						
08:01-09:00						
09:01-10:00						
10:01-11:00						
11:01-12:00						
12:01-13:00						
13:01-14:00						
14:01-15:00						
15:01-16:00						
16:01-17:00						
17:01-18:00						
18:01-19:00						
19:01-20:00						
20:01-21:00						
21:01-22:00						
22:01-23:00						
23:01-00:00						



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Tabela 4: Rënie dhe çrregullime në funksionimin e sistemit pagesor

Muaj (MM.VVVV)	Numri i rënieve / çrregullimeve	Kohëzgjatja e rënieve / çrregullimeve (në minuta)	Numri i orëve të rregullta të punës në sistemin pagesor në muajin (OO:MM)	Numri i orëve shitesë të punës në sistemin pagesor në muajin (OO:MM)



Tabela 4.1: Përshkrim i rënieve dhe çrregullimeve individuale në funksionimin e sistemit pagesor

Data (DD.MM.VVVV)	Kohëzgjatja e rënieve / çrregullimeve (në minuta)	Përshkrimi

Tabela 5: Pasqyrë e detyrimeve dhe kërkesave neto financiare sipas datës së shlyerjes

Data (DD.MM.VVVV)	Emri i pjesëmarrësit	Pozicioni neto (në denarë)

Tabela 6: Gjendja e mjeteve të destinuara për udhëheqje me rreziqet likuide

Muaji (DD.MM.VVVV)	Pjesëmarrës në sistemin	Mjetet e pjesëmarrësit (në denarë)

Operatori i sistemit pagesor dorëzon të dhëna për gjendjen e mjeteve të ditës së fundit të çdo muaji në tremujorin, për të cilin raporton dhe ad-hoc raport për gjendjen e ditës në të cilën ka ndodhur ndryshim i mjeteve.